



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L-027

**PËR DIXHITALIZIMIN E TRANSMETIMEVE RADIODIFUZIVE
TOKËSORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR DIXHITALIZIMIN E TRANSMETIMEVE RADIODIFUZIVE
TOKËSORE**

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të rregullojë procesin kalues nga transmetimi analog në atë dixhital në Republikën e Kosovës, të përcaktojë kushtet për zbatimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore dixhitale, të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e operatorëve të rrjeteve, operatorëve të multipleksëve dhe ofruesve të shërbimeve mediale, ndryshimet në menaxhimin e brezit radio frekuencor brenda rangut të frekuencave 61-69 UHV (790-862 MHz), i cili do të lirohet për dividentin dixhital, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin efikas të brezit radio frekuencor, i cili në pajtim me aktet juridike nacionale dhe ndërkombëtare është i paraparë për transmetimin e programeve radiotelevizive.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj rregullon metodën dhe kushtet për transmetimet radiodifuzive tokësore dixhitale, procedurën për kalimin nga transmetimet radiodifuzive analoge në ato dixhitale.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - është organi rregullator që zbaton dhe mbikëqyrë kornizën ligjore të definuar nga Ligji për komunikimet elektronike (në tekstin e mëtejme 'Autoriteti');

1.2. Dixhitalizimi – procesi i kalimit nga transmetimet radiodifuzive analoge në ato dixhitale/numerike;

1.3. Kanalet televizive të licencuara për transmetim analog tokësor - janë të gjitha subjektet e licencuara nga KPM për transmetimin radiodifuziv analog në Republikën e Kosovës, qofshin ato me licenca për transmetim në tërë territorin apo me licenca për transmetim rajonal/lokal;

1.4. Kapaciteti i gjithmbarshëm transmetues i multipleksit - nënkupton sasinë më të madhe të të dhënave dhe sinjaleve dixhitale që mund të transmetohen gjatë një njësie kohore të caktuar;

1.5. Komisioni i Pavarur për Media - është organ i pavarur për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit i cili rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e personave juridikë që ofrojnë shërbime mediale, audio dhe audiovizuale, të cilat përkufizohen në Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media (në tekstin e mëtejme 'KPM');

1.6. Ministria - është Ministria përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike (në tekstin e mëtejme 'Ministria');

1.7. Multipleksi - është një set i standardizuar i sinjaleve dixhitale, i shprehur në Mb/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur;

1.8. Must carry - nënkupton bartje të detyrueshme;

1.9. Ofruesi i shërbimeve mediale - është personi fizik apo juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes së programeve audio apo audiovizuale të shërbimit mediatik audiovizual dhe i cili përcakton mënyrën se si ato do të organizohen;

1.10. Operatori i multipleksit - është personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve dixhitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin dixhital të të dhënave;

1.11. Operatori i rrjetit - është çdo person juridik, i cili ofron çfarëdo forme të rrjetit për transmetim të programeve, ose një shërbim transmetimi për publikun dhe posedon licencën korresponduese, ose autorizim të lëshuar nga KPM-ja;

1.12. Plani Kombëtar i Radio-Frekuencave - nënkupton dokumentin që përcakton brezat frekuencorë për shërbimet e ndryshme dhe kushtet bazike për ndarjen dhe dhënien e frekuencave, me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit efektiv të spektrit të radio-frekuencave dhe shmangies së interferencave;

1.13. Pranuesi Televiziv Dixhital - është pajisja për pranimin, dekodimin dhe transformimin e sinjalit televiziv dixhital në një formë të përshtatshme për riprodhimin e fotografisë, zërit dhe të dhënave tjera, e cila mund të jetë pajisje e veçantë, e vendosur brenda televizorit, apo në një tjetër pajisje;

1.14. Qasja në multipleks - nënkupton shërbimin e ofruar nga operatori i rrjetit përmes rrjetit të komunikimit elektronik, nga pika e qasjes në rrjet;

1.15. Transmetim radiodifuziv – shërbimi i transmetimit të programeve të radios dhe televizionit nëpërmjet një antene tokësore, rrjetit të komunikimeve elektronike, ose satelitore, në formë të koduar ose jo, për t'u marrë nga publiku;

1.16. Transmetimi radiodifuziv analog - është transmetimi dhe pranimi i sinjalit analog televiziv dhe/ose të radios përmes transmetuesve tokësorë, në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare;

1.17. Transmetimi radiodifuziv tokësor dixhital - është transmetimi dhe pranimi i sinjalit dixhital televiziv dhe/ose të radios përmes transmetuesve tokësorë, në pajtim me standardet relevante ndërkombëtare;

1.18. Televizioni me kualitet standard SDTV - është shërbimi i fotografisë dhe zërit të cilësisë standarde, në pajtim me rekomandimet relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU);

1.19. Televizioni me kualitet të lartë HDTV - është shërbim që ofron fotografi dhe zë me cilësi më të lartë sesa cilësia standarde, duke i shtuar numrin e linjave analizuese për fotografi, duke ndryshuar metodën e analizës së fotografisë, duke e rritur proporcionin e faqeve të fotografisë në 16:9, si dhe duke i ndryshuar karakteristikat kolorometrike të fotografisë, në pajtim me rekomandimet relevante të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikacion (rekomandimet e ITU).

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Ligj do të kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

KAPITULLI II

PLANIFIKIMI, ZHVILLIMI DHE SHFRYTËZIMI I RRJETEVE DHE E DREJTA PËR QASJE NË MULTIPLEKS PËR EMETIM DIXHITAL TOKËSOR

Neni 4

Planifikimi i rrjetit

1. Rrjeti do të planifikohet nga operatori i rrjetit në pajtim me kushtet e tenderit publik për ndarjen e radio-frekuencave për transmetim radiodifuziv, në përputhje me Planin Kombëtar për Radio-Frekuenca dhe me Planin për Shfrytëzimin e Radio-Frekuencave (kanaleve).
2. Plani Kombëtar për Radio-Frekuenca përcakton brezat frekuencorë për shërbimet e ndryshme dhe vendosë kushtet bazë për ndarjen dhe dhënien e frekuencave me qëllim të shfrytëzimit efektiv të radiofrekuencave dhe shmangien e interferencave.
3. Plani Kombëtar për Radio-Frekuenca do të përgatitet nga Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë, në pajtim me Ligjin për komunikimin elektronik.
4. Plani për Shfrytëzimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) do të përgatitet nga KPM në bashkëpunim me Autoritetin, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Neni 5

Operatori i rrjetit

Të gjithë personat juridikë që janë pajisur me licencë për transmetim të programeve përmes rrjetit transmetues radiodifuziv tokësor dixhital dhe me licencë për t'i shfrytëzuar frekuencat, në pajtim me Ligjin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Ligjin për komunikimet elektronike, kanë statusin e operatorit të rrjetit.

Neni 6

Operatori i multipleksit

1. Të gjithë personat juridikë që ofrojnë shërbime të komunikimeve elektronike publike të menaxhimit të multipleksëve, bazuar në njoftimet sipas dispozitave të Ligjit për komunikimet elektronike, do të kenë statusin e operatorit të multipleksit.
2. Për shpërndarjen e programeve të radios dhe/ose televizionit, operatori i multipleksit do të pajiset me miratim për shpërndarje nga KPM, në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Neni 7
Marrëdhënia e operatorëve të rrjetit dhe operatorëve të multipleksit

1. Operatori i rrjetit mund të jetë, gjithashtu edhe operator i multipleksit.
2. Operatori i multipleksit mund të jetë, gjithashtu edhe operator i rrjetit.
3. Operatori i rrjetit që është edhe operator i multipleksit, do të mbajë llogari të ndara kontabël për veprimtaritë e ndërlidhura me menaxhimin e multipleksit dhe menaxhimin e rrjetit.
4. Në rast se ofruesi i shërbimeve mediale është në të njëjtën kohë edhe operator i multipleksit, KPM do të përcaktojë rregulla për mbajtjen e llogarive të ndara, për evitimin e monopolit dhe sigurimin e konkurrencës në tregun medial në frymën e Direktivës Evropiane nr.2002/77.

Neni 8
Ndarja e kapaciteteve të multipleksit

1. Me qëllim të sigurimit të shfrytëzimit më racional të kapaciteteve të multipleksit është e mundur që të ndahen kapacitetet për ofrimin e shërbimeve mediale audiovizuale dhe shërbimeve për komunikimet elektronike.
2. Ndarja e multipleksit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, realizohet nga KPM.
3. Cilësia e shërbimeve elektronike që i referohet paragrafit 1 të këtij neni, duhet jetë në pajtim me parametrat e cilësisë së shërbimeve të përcaktuara në Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Neni 9
Qasja në multipleks

Para qasjes në kapacitetin e multipleksit të ndarë, programet e radios dhe televizionit duhet të kodohen në pajtim me standardin kodues të ITU-T-së H.264/AVC (MPEG-4, Versioni10) ose më të ri.

KAPITULLI III
MENAXHIMI I MULTIPLEKSIT

Neni 10
Operatori i multipleksit si menaxher

1. Multipleksi menaxhohet nga operatori i multipleksit që ka marrë frekuencë nga KPM të paraparë për transmetime radiodifuzive dixhitale.

2. Operatori i multipleksit në një zonë të veçantë gjeografike është i obliguar t'u sigurojë të gjithë ofruesve të shërbimeve mediale kushte të barabarta dhe jodiskriminuese të qasjes në multipleksin që menaxhohet nga operatori i multipleksit, në kuptim të së drejtës për të shpërndarë programe, duke shfrytëzuar teknologji transmetuese radio difuzivedixhitale në zonën gjeografike relevante.

3. Nëse një Ofrues i Shërbimeve Mediale është në të njëjtën kohë edhe Operator i Multipleksit do të mbajë llogari të ndara kontabël për ato veprimtari.

KAPITULLI IV PERIUDHA E KALIMIT

Neni 11 Periudha e kalimit

1. Kalimi nga transmetimet radiodifuzive analoge në ato dixhitale do të përfundojë deri në një datë të caktuar me Vendim të veçantë nga ana e KPM.

2. Personat juridikë që në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji posedojnë miratimin për të shfrytëzuar frekuencat, do të ndërpresin emetimin e programeve të tyre televizive në teknologjinë analoge jo më vonë se deri në datën e caktuar me Vendim të veçantë nga ana e KPM, të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

3. Metoda për informimin e publikut dhe udhëzimet praktike për përdoruesit fundorë para dhe pas kalimit do të përcaktohen nga KPM.

4. Të gjithë operatorët që shfrytëzojnë radio frekuenca në brezin 790 – 862 MHz duhet të lirojnë kanalet frekuencore në shfrytëzim dhe të hapin mundësitë për shërbimet mobile brezëgjëra, jo më vonë se deri në datën e caktuar me Vendim të veçantë nga ana e KPM, të referuar në paragrafin 1 të këtij Neni.

Neni 12 Masat stimuluese për konsumatorë

1. Qeveria do të mbështesë, me fondet në dispozicion, realizimin e transmetimeve radiodifuzive dixhitale, përmes masave stimuluese për konsumatorë, apo bashkëfinancimit të blerjes së marrësve të sinjalit televiziv dixhital për konsumatorët në gjendje shoqërore më të pafavorshme.

2. Marrësit e bashkëfinancuar nga Qeveria do të jenë neutralë në aspektin teknologjik dhe do të shfrytëzojnë standarde të hapura të ndërveprimit.

3. Në pajtim me këtë nen, përfitues të masave të tilla stimuluese janë kategoritë e rasteve sociale, të cilat janë të përcaktuara nga Ministria përkatëse për çështje sociale.

4. Ministria përkatëse për çështje sociale do të bëjë ftesë publike për personat që kanë të drejtë të aplikojnë për bashkëfinancim për marrjen e vaçerit për marrës televiziv dixhital dhe do të përcaktojë përfituesit që do të bashkëfinancohen.

Neni 13 **Aranzimet speciale për transmetuesin publik**

Me qëllim të transmetimit radiodifuziv dixhital të sinjaleve të shërbimeve të transmetuesit publik, transmetuesit publik i jepet e drejta për një multipleks, me mbulueshmëri në tërë territorin e Republikës së Kosovës, pa kryer procedurën e thirrjes publike. Transmetuesi publik përdorë multipleksin për kanalet e veta dhe eventualisht për kanalet tjera jokomerciale nën kushtet e miratuara nga KPM.

Neni 14 **Tenderi publik**

1. Përveç elementeve të përcaktuara me Ligjin për Komunikimet Elektronike, vendimi për iniciimin e tenderit publik për ndarjen e radio-frekuencave për multipleks do t'i përmbajë të gjitha specifikacionet thelbësore të multipleksit për të cilin tenderohet radio-frekuenca, siç janë frekuenca, zona e mbulueshmërisë, kapaciteti i kanaleve, masa e kapaciteteve rezervë dhe elementet tjera në pajtim me këtë ligj.

2. Vendimi për iniciimin e tenderit publik do të merret nga KPM.

3. Vendimi për iniciimin e tenderit publik, sipas paragrafit 1 të këtij neni do të përcaktojë qartas kushtet për shfrytëzimin e kapaciteteve për ofruesit e shërbimeve mediale gjatë periudhës së kalimit, me qëllim të krijimit të kushteve për shfrytëzimin e televizioneve me kualitet të lartë (HDTV).

4. Përveç elementeve tjera të kërkuara që përbëjnë aplikacionin për ndarjen e radio-frekuencave, KPM gjithashtu në tenderin për dhënien e radio-frekuencave, apo sistemit të multipleksit do të përfshijë kornizën kohore dhe planin hapësinor brenda të cilave do ta krijojë rrjetin.

KAPITULLI V **TË DREJTAT DHE DETYRIMET PËR TË SHFRYTËZUAR RADIO- FREKUENCAT**

Neni 15 **Kohëzgjatja e vlefshmërisë, ndryshimi, zgjatja, revokimi dhe ndërprerja e vendimit për ndarjen e radio-frekuencave për multipleks dhe bartja e të drejtave për të shfrytëzuar radio-frekuencat**

Sa i përket vlefshmërisë, ndryshimit, zgjatjes, revokimit dhe ndërprerjes së vendimit për ndarjen e radio-frekuencave për një sistem multipleksi dhe për bartjen e të drejtave për të

shfrytëzuar radio-frekuencat për multipleks, do të zbatohen dispozitat për vlefshmërinë, ndryshimin, zgjatjen, bartjen, revokimin dhe ndërprerjen e vendimit për ndarjen e radio-frekuencave, të cilat përcaktohen në Ligjin për Komunikimet Elektronike, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.

Neni 16

Dispozitat e veçanta mbi bartjen e së drejtës për shfrytëzim të radio-frekuencave për multipleks

Në rast se operatori i një sistemi të multipleksit ka për qëllim ndërprerjen e veprimtarisë, ai do t'ia paraqesë kërkesën KPM-së për bartjen e së drejtës për të shfrytëzuar radio-frekuencat për sistem të multipleksit. Nëse operatori nuk e bën këtë së paku tre (3) muaj para ndërprerjes së planifikuar të veprimtarisë, kërkesa për bartje të së drejtës për shfrytëzimin e radio-frekuencave për sistem multipleksi mund të dorëzohet nga ofruesit e cilitdo shërbim në këtë sistem multipleksi.

Neni 17

Pagesat për shfrytëzimin e radio-frekuencave për multipleks

1. Operatorët e licencuar, të cilëve u janë ndarë radio-frekuencat për multipleks, do të obligohen që t'ia paguajnë KPM-së një pagesë vjetore për shfrytëzimin e radio-frekuencave në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Shuma minimale e pagesave në fjalë përcaktohet më rregullore të miratuar nga KPM. Gjatë përcaktimit të nivelit të pagesës dhe metodës së kryerjes së pagesës në fjalë, merren parasysh oferta dhe kërkesa për frekuencat e lëshuara në përdorim, zhvillimi i tregut në të cilin aplikohen këto frekuenca, por kjo lartësi e shumës duhet të siguroj konkurrencë dhe barazi në treg.
3. Të hyrat sipas paragrafit 2 të këtij neni do të derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

KAPITULLI VI

KUFIZIMET OPERATIVE TË MULTIPLEKSIT

Neni 18

Përfshirja e detyrueshme e disa programeve të radios dhe televizionit në multipleks

1. Operatori i multipleksit në nivel shtetëror duhet të sigurojë përfshirjen në multipleks me rregullat "must carry", të dy programeve të transmetuesit publik në afat të pacaktuar dhe të dy kanaleve me mbulim shtetëror të licensuara nga KPM për transmetim tokësor deri në përfundim të afatit të licencës.
2. Operatorët e multipleksit në nivel rajonal duhet të sigurojë përfshirjen në multipleks me rregullat "must carry", të të gjitha kanaleve rajonale dhe lokale të licensuara nga KPM për

transmetim tokësor, në pajtim me politikat strategjike të KPM. KPM do t'i përcaktojë procedurat dhe kushtet e dhënies më koncesion të multipleksëve përkatës lokalë dhe rajonalë.

3. Kriteret për përfshirjen sipas rregullave “must carry”, përcaktohen me një akt nënligjor të nxjerrë nga KPM, jo më vonë se gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

4. Kriteret që i referohen paragrafit 3 të këtij neni bëhen në përputhje me analizën e tregut dhe nevojat publike të Republikës së Kosovës.

5. KPM përcakton renditjen numerike të kanaleve televizive të licencuara, të përfshira me rregullat “must carry”, me akt nënligjor të veçantë.

Neni 19

Kufizimet lidhur me të drejtën për të shpërndarë programet duke shfrytëzuar teknologjinë e emetimit dixhital

1. Në pajtim me Ligjin për KPM-në, KPM nuk do të licencojë ofrues të shërbimeve mediale, për shpërndaje me multipleksë tokësorë dixhital, në rast se multipleksi funksional, ose i tenderuar nuk ka kapacitet rezervë për këtë qëllim.

2. Nëse Ofruesi i shërbimeve mediale nuk fillon shpërndarjen e përmbajtjes brenda afatit tremujor pas licensimit për shërbim audiovizuel në një zonë të caktuar, me kusht që të gjitha kushtet teknike dhe juridike të jenë plotësuar, KPM do të iniciojë procedurën për revokimin e licencës së ofruesit të shërbimeve mediale sipas detyrës zyrtare.

Neni 20

Kufizimet për qëllime të televizionit me rezolucion të lartë

1. Në tenderin publik për ndarjen e radio-frekuencave për multipleks, KPM mund të përcaktojë se i gjithë kapaciteti, apo një pjesë e kapacitetit të multipleksit të rezervohet për shpërndarje të programeve që shfrytëzon teknologji për televizion me rezolucion të lartë.

2. Në tenderin publik për dhënien e radio-frekuencave për multipleks, KPM mund të vendosë se një pjesë e kapacitetit të multipleksit do të rezervohet për ofrues të ndryshëm në këtë multipleks, ashtu që të mundësojë transmetim të kohëpaskohshëm duke shfrytëzuar teknologji të televizionit me rezolucion të lartë. Kjo pjesë e kapacitetit të multipleksit do të shfrytëzohet për shpërndarjen e kapaciteteve aktuale të kanaleve televizive të veçanta që zakonisht emitojnë programet në rezolucion më të ulët me qëllim të transmetimit të programeve, duke shfrytëzuar teknologji televizive me rezolucion të lartë. Një pjesë e kapaciteteve të rezervuara për këtë qëllim do të vihet në dispozicion në kushte të barabarta dhe jodiskriminuese për transmetimin dhe shpërndarjen e programeve të të gjithë ofruesve brenda këtij multipleksi.

3. Nëse KPM vepron sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, ajo do të jetë e obliguar që të përcaktojë në vendimin për iniciimin e tenderit publik pjesën e kapacitetit që duhet të jetë i rezervuar nga operatori i multipleksit. Pjesa e kapacitetit të multipleksit të rezervuar kështu duhet t'i sigurojë ofruesit të shërbimeve mediale pjesën e vet të kapaciteteve të multipleksit

për të transmetuar dhe shpërndarë programe duke shfrytëzuar teknologjinë televizive me rezolucion të lartë.

4. Operatori i multipleksit mund të ndajë shfrytëzimin e kapaciteteve të cilave u referohet në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni sipas kohës së transmetimeve ditore dhe të ofrojë hapësira kohore (termine) të veçanta nën kushte të ndryshme. Shfrytëzimi i tillë mund të përcaktohet edhe përmes ankandit.

KAPITULLI VII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 21 Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Cilido person juridik, pronar i vetëm apo individ i vetëpunësuar do të gjobitet për kundërvajtje me ndëshkim prej pesëdhjetë mijë (50.000) euro deri pesqindë mijë (500.000) euro, në rast se personi në fjalë:

1.1. krijon një rrjet në kundërshtim me këtë ligj;

1.2. dështon të veprojë në pajtim me detyrimet që rrjedhin nga vendimet e KPM-së dhe Autoritetit;

1.3. nuk mundëson kushte të barabarta dhe jodiskriminuese për qasje në sistemin e multipleksit;

1.4. shfrytëzon radio-frekuencat për multipleks pa vendim valid për ndarjen e radio-frekuencave;

1.5. dështon të veprojë në pajtim me vendimin për ndarjen e radio-frekuencave për multipleks;

2. Gjoba mes pesëmijë (5.000) euro dhe dhjetëmijë (10.000) euro do t'u shqiptohet të gjithë personave përgjegjës të personit juridik, personit përgjegjës të pronarit të vetëm dhe personit përgjegjës të vetëpunësuar për kryerjen e kundërvajtjeve, të cilave u referohet në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Gjoba mes njëmijë (1.000) euro dhe pesëmijë (5.000) euro do t'u shqiptohet individëve për kryerjen e kundërvajtjeve të cilave u referohet në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Gjobat sipas këtij neni paguhen në buxhetin e Kosovës.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 22 Mbikëqyrja e zbatimit

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji do të bëhet nga KPM, për sa i përket përmbajtjes dhe nga Autoriteti për sa i përket cilësisë së shërbimeve.

Neni 23 Zbatimi i Ligjit për Komunikimet Elektronike dhe Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave

Ligji për Komunikimet Elektronike do të zbatohet për çështjet nga fusha e Komunikimeve Elektronike që nuk rregullohen në mënyrë të veçantë nga ky ligj, ndërsa Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave do të zbatohet për çështjet nga fusha e shërbimeve mediale dhe audiovizuale, të cilat nuk rregullohen në mënyrë të veçantë nga ky ligj.

Neni 24 Miratimi i Planit për Shfrytëzimin e Radio-Frekuencave (kanaleve)

KPM do ta miratojë Planin për Shfrytëzimin e Radio-Frekuencave (kanaleve) për transmetimet radio difuzive, brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në pajtim me nenin 4 të këtij ligji, Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Neni 25 Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren nga KPM në pajtim me politikat strategjike për kalimin nga transmetimi analog në atë dixhital në Republikën e Kosovës, gjashtë (6) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 26 Zbatimi i ligjit

Ky ligj do të zbatohet për periudhën e kalimit nga transmetimi analog në atë dixhital në Republikën e Kosovës sipas Vendimit të veçantë të KPM, të referuar në paragrafin 1 të Nenit 11 të këtij Ligji.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-027
30 korrik 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kadri VESELI



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -027

**PËR DIXHITALIZIMIN E TRANSMETIMEVE RADIODIFUZIVE
TOKËSORE**

SHTOJCA

**RREGULLAT PËR PËRMBAJTJEN DHE PROCEDURËN PËR TENDERË
PUBLIKË PËR KANALET 46 DHE 58**

Neni 1
Tenderi Publik

KPM shpallë tender publik për lejimin e dy multipleksëve (kanalet 46 dhe 58), në pajtim me këtë ligj.

Neni 2
Publikimi i Vendimit

1. KPM do të publikojë Vendimin për shpalljen e tenderit publik në Gazetën Zyrtare.
2. Vendimi do të publikohet edhe në ueb-faqen e KMP-së dhe në shtypin vendor dhe ndërkombëtar, si dhe me mjete tjera përkatëse.

Neni 3
Përmbajtja e Vendimit për shpalljen e tenderit publik

1. Vendimi për ta shpallur një tender publik do të përmbajë veçanërisht si në vijim:
 - 1.1. objektin e tenderit publik, që do të jetë multipleksi në dispozicion;
 - 1.2. kushtet e përgjithshme dhe programore;

1.3. dëshmitë e nevojshme për të fituar të drejtën për të paraqitur ofertë në procedurën e tenderit publik;

1.4. mënyrën e pagesës së vlerës së tarifës për koncesionin për multipleksin, si dhe mënyrën e pagesës së vlerës së tarifave për dokumentacionin e tenderit dhe për të paraqitur ofertë në tenderin publik;

1.5. informatat mbi pagesën administrative për shfrytëzimin e frekuencave;

1.6. afatin për dorëzimin e kërkesës për dokumentacionin e tenderit në KPM, që nuk mund të jetë më i gjatë se tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit të Vendimit për shpalljen e tenderit publik;

1.7. afatin për dorëzimin e ofertës tek KPM, që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e publikimit të Vendimit për shpalljen e tenderit publik (në tekstin e mëtejme 'Afati i Tenderit');

1.8. informatën se oferta që nuk i plotëson kushtet e përshkruara në Vendimin për shpalljen e tenderit publik dhe/ose që nuk është përgatitur në pajtim me dokumentacionin e tenderit nuk do të pranohet;

1.9. informatën se oferta duhet të dorëzohet në KPM në gjashtë (6) kopje, një prej të cilave do të jetë origjinale dhe do të përmbajë nënshkrimin e personit përgjegjës, të cilat vendosen në zarf të mbyllur, në të cilin shënohet emri i plotë dhe adresa e ofertuesit, si dhe teksti vijues: "Të mos hapet – Ofertë për tenderin publik për dhënien e lejes së koncesionit për multipleks";

1.10. informatën se ofertat e dorëzuara dhe pagesat e kryera nuk do të kthehen;

1.11. informatën se brenda dhjetë (10) ditësh nga data e skadimit të afatit të tenderit, KPM do të informojë të gjitha palët e përfshira në procedurën e tenderit publik për kohën dhe vendin ku do të mbahet seanca e KPM-së në të cilën do të hapen publikisht të gjitha ofertat e dorëzuara brenda afatit të tenderit;

1.12. afatin përfundimtar deri në të cilin KPM duhet të marrë vendimin e vet për koncesionin që është objekt i tenderit publik, e i cili nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e hapjes publike të ofertave.

2. Dokumentacioni i tenderit duhet të përpilohet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

3. Dokumentacioni i tenderit duhet të përgatitet në pajtim me vendimin relevant për shpalljen e tenderit publik.

Neni 4 Dokumentacioni i tenderit

1. Dokumentacioni i tenderit duhet që të përmbajë posaçërisht si në vijim:

1.1 . informatat e përgjithshme për ofertuesin;

1.2 . informatat e sakta për afatin dhe vendin e dorëzimit të ofertave sipas nenit 3 të kësaj Shtojce;

1.3. informatat e sakta për afatin dhe mënyrën e nxjerrjes së vendimit të KPM-së sipas nenit 3 të kësaj Shtojce;

1.4. informatat mbi parametrat teknikë të përcaktuar nga Autoriteti.

1.5. Kushtet dhe e drejta për të marrë pjesë në tenderët publikë; Kriteret kryesore; Standardet teknike (p.sh. MPEG 4 - DVBT2) kapacitetet teknike; Kategorizimi - Nacional, rajonal dhe lokal dhe mbulimi për secilën kategori në veçanti.

Neni 5 Komisioni Mbikëqyrës

1. Me qëllim të promovimit të transparencës dhe sigurimit të bashkëndimit të ngushtë mes autoriteteve publike, i tërë procesi do të mbikëqyret nga Komisioni Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme KM), në përbërjen si në vijim:

1.1. tre (3) përfaqësues të KPM-së;

1.2. dy (2) përfaqësues të Autoritetit;

1.3. një (1) përfaqësues i Ministrisë;

2. KM kryesohet nga përfaqësuesi i KPM-së.

3. KM do ta mbikëqyrë procedurën e tenderit publik duke përfshirë edhe formimin e Komisionit Vlerësues (në tekstin e mëtejme KV) dhe shqyrtimin e rekomandimeve të KV.

4. KM vendimet i merr me shumicë votash, në rastet kur të pranishëm janë së paku katër (4) anëtarë. Secili nga anëtarët, përfshirë kryesuesin, kanë të drejtë në një votë, ndërsa për të gjitha çështjet që shtjellohen do të votohet me shumicën e votave të pjesëtarëve që votojnë. Në rast se votat janë të barabarta, vota e kryesuesit konsiderohet votë e dyfishtë dhe me të vendoset çështja në fjalë.

Neni 6 Komisioni Vlerësues

1. KV i caktuar me vendim të KM, i rekomandon KM për miratim ofertën më të mirë në tenderin publik për multipleks.

2. KM nxjerr vendim për dhënien e koncesionit për operatorin e multipleksit.

Neni 7 Oferta

1. KPM do t'ia sigurojë dokumentacionin e tenderit të gjithë personave që kanë paraqitur kërkesë për sigurimin e dokumentacionit të tenderit brenda afatit të tenderit dhe që kanë parashtruar dëshminë e kryerjes së pagesës sipas nenit 3 të kësaj Shtojce.
2. Ofertën në tenderin publik mund ta parashtrojnë të gjithë personat juridikë që e kanë marrë dokumentacionin e tenderit, në pajtim me këtë Shtojcë.
3. Oferta sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të përpilohet në njërën nga gjuhët shqipe, serbe apo angleze.

Neni 8 Publikimi i të dhënave të ofertuesve

Emri, selia dhe informatat tjera të ofertuesit në tenderin publik do të mbeten të pazbuluara deri në momentin e hapjes publike të ofertave relevante.

Neni 9 Afatet

Të gjitha kërkesave për sqarime shtesë lidhur me dokumentacionin e tenderit, të cilat pjesëmarrësit në procedurën e tenderit publik mund t'ia paraqesin KPM-së jo më vonë se dhjetë (10) ditë para skadimit të afatit të tenderit, KPM do t'u japë përgjigje brenda shtatë (7) ditësh nga data e kërkesës me shkrim. KPM obligohet që përgjigjen e vet t'ia dërgojë të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e tenderit publik njëkohësisht, pa zbuluar çfarëdo informate mbi parashtruesin e kërkesës fillestare për sqarim shtesë.

Neni 10 Ndryshimet dhe plotësimet në dokumentacionin e tenderit

1. Në rastet kur KPM do duhej të ndryshojë apo plotësojë kushtet e tenderit publik apo vendimin për ta shpallur tenderin publik para skadimit të afatit të tenderit, ndryshimi apo plotësimi në fjalë duhet të publikohet në mënyrën e njëjtë me publikimin e vendimit fillestar për të shpallur tenderin publik.
2. Ndryshimi, apo plotësimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet t'u dërgohet të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e tenderit publik, të cilët e kanë pranuar dokumentacionin e tenderit.
3. Në rastet kur kushtet e ndryshuara, apo të plotësuara të tenderit publik mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në përpilimin e ofertave, apo nëse ato publikohen pasi të ketë kaluar më shumë se gjysma e afatit të tenderit, afati i tenderit duhet të zgjatet.

Neni 11

Afatet për ndryshimet dhe plotësimet në dokumentacionin e tenderit

1. Në bazë të parashikimit të vet apo në bazë të kërkesës për sqarime shtesë me shkrim, sipas nenit 10 të kësaj Shtojce, KPM mund të ndryshojë apo plotësojë dokumentacionin e tenderit të vet para skadimit të afatit të tenderit, në formë të një shtojce.
2. Kjo shtojcë me ndryshime, apo plotësime të dokumentacionit të tenderit duhet t'u dërgohet nga KPM, pa pagesë, të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e tenderit publik të cilët e kanë pranuar dokumentacionin e tenderit, jo më vonë se dhjetë (10) ditë para skadimit të afatit të tenderit.
3. KPM mund ta zgjasë afatin e tenderit me qëllim të ndryshimit, apo plotësimit të dokumentacionit të tenderit. Njoftimi për zgjatjen e afatit të tenderit do t'u dërgohet nga KPM të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e tenderit publik, si dhe do të publikohet në të njëjtën mënyrë me publikimin e vendimit fillestar për ta shpallur tenderin publik.
4. Dokumentacioni i tenderit nuk do të ndryshohet, apo plotësohet pas skadimit të afatit të tenderit.

Neni 12

Përmbajtja e ofertës së tenderit publik

1. Oferta në tenderin publik duhet të përmbajë:
 - 1.1. dëshmi për plotësimin e kushteve të përcaktuara me tender publik;
 - 1.2. bazën programatike, e cila duhet të përmbajë skemën programore që përmban:
 - 1.2.1. në rast të një kanali të përgjithshëm me program radio, ose televiziv:
 - 1.2.1.1. llojin e programeve audiovizuale, apo të radios, d.m.th. klasifikimin e tyre në grupe specifike programore;
 - 1.2.1.2. proporcionin e parashikuar kuantitativ mes grupeve të ndryshme të përmbajtjes;
 - 1.2.1.3. vëllimin e parashikuar maksimal të përmbajtjes reklamuese;
 - 1.2.1.4. vëllimin e parashikuar të produksionevevetanake dhe proporcionin e programeve audio dhe audiovizuale të punuara në Kosovë;
 - 1.2.1.5. proporcionin e programeve audiovizuale evropiane dhe të programeve audiovizuale nga prodhuesit e pavarur;
 - 1.2.1.6. kohën e emetimit;
 - 1.2.2. në rast të një kanali të specializuar me program radio ose televiziv:

1.2.2.1. llojin e programeve audiovizuale, apo të radios, më shumë se 70% e së cilave duhet të jenë të njëjtit lloj;

1.2.2.2. proporcionin e parashikuar kuantitativ mes grupeve të ndryshme të përmbajtjes;

1.2.2.3. vëllimin e parashikuar maksimal të përmbajtjes reklamuese;

1.2.2.4. vëllimin e parashikuar të produksionevevetanake dhe proporcionin e programeve audio dhe audiovizuale të punuara në Kosovë;

1.2.2.5. proporcionin e programeve audiovizuale evropiane dhe të programeve audiovizuale nga prodhuesit e pavarur;

1.2.2.6. kohën e emetimit.

1.3. të dhënat mbi strukturën e pronësisë së personit juridik që paraqet ofertën;

1.4. të dhënat personale mbi kompaninë dhe selinë e saj, d.m.th. emrin dhe mbiemrin dhe vendbanimin e përhershëm të personave që në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë, përmes personave të tjerë juridikë, kanë pronësi ose aksione në personin juridik në fjalë, si dhe të dhënat mbi përqindjen e aksioneve të mbajtura;

1.5. të dhënat mbi gjendjen financiare të ofertuesit.

Neni 13

Procedura e hapjes publike

1. KPM do ta realizojë procedurën e hapjes publike të ofertave të dorëzuara brenda afatit të tenderit në një seancë të hapur për publikun.

2. Ofertat e dorëzuara pas skadimit të afatit të tenderit nuk do të merren parasysh.

Neni 14

Procesverbali

KPM do të mbajë procesverbal të hapjes publike të ofertave, i cili do të jetë pjesë integrale e procesverbalit të seancës përkatëse të KPM-së.

Neni 15

Vlerësimi i ofertave

1. Pas realizimit të procedurës së tenderit publik, KV do ta marrë vendimin relevant për përzgjedhjen e ofertës më optimale dhe mbi dhënien e koncesionit që ka qenë objekt i tenderit publik që duhet miratuar nga KM.

2. Procedura për përcaktimin e ofertës më optimale do të realizohet nga KV përmes ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të të gjitha ofertave të hapura.
3. Në rast të tërheqjes së ofertuesit fitues, KPM do ta anulojë tenderin publik në fjalë.

Neni 16

Vendimi për dhënien e koncesionit për operatorin e multipleksit

1. Vendimi për dhënien e koncesionit për operatorin e multipleksit do të përmbajë:
 - 1.1. emrin e autoritetit që e jep koncesionin (KPM), numrin dhe datën në të cilën do të merret vendimi;
 - 1.2. emrin e tenderuesit;
 - 1.3. objektin e koncesionit;
 - 1.4. një përshkrim të veprimtarive që do të kryhen;
 - 1.5. nivelin dhe fushën e koncesionit;
 - 1.6. datën e skadimit të periudhës së koncesionit;
 - 1.7. shumën e pagesës së koncesionit;
 - 1.8. afatin për nënshkrimin e kontratës relevante të koncesionit nga ana e ofertuesit më optimal;
 - 1.9. pasojat për mospajtueshmëri me afatin për lidhjen e kontratës së koncesionit;
 - 1.10. një sqarim mbi arsyet për përzgjedhjen e ofertuesit të caktuar;
 - 1.11. udhëzimet për mjetet juridike;
 - 1.12. nënshkrimin e personit përgjegjës dhe vulën e autoritetit që e jep koncesionin.

Neni 17

Rastet për anulimin e Tenderit

1. KPM do ta miratojë vendimin për anulimin e tenderit publik, apo një pjese të tenderit publik në rastet si në vijim:
 - 1.1. nëse nuk dorëzohet asnjë ofertë, e cila do të ishte e pranueshme sipas kushteve të tenderit publik;
 - 1.2. nëse para skadimit të tenderit publik vërtetohet se dokumentacioni i tenderit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme.

Neni 18
Publikimi i Vendimit

Vendimi për dhënien e koncesionit publikohet në Gazetë Zyrtare.

Neni 19
Fletëpranimi

Vendimi për dhënien e koncesionit do t'u dërgohet të gjithë ofertuesve, gjë që do të vërtetohet me fletëpranim.

Neni 20
Ankesa

Kundër Vendimit të KM, pala e pakënaqur ushtron padi në Gjykatën kompetente.